



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		07.07.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJÇA PRILOG
01-	052/01-	30589	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	07.07.2026
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi– Nënkryetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik nga Draft Rregulloreja për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Qytetin e Lipjanit

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, **Komisioni për Draft Rregulloren për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Qytetin e Lipjanit** dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft Rregulloren për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Qytetin e Lipjanit

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik draft rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në qytetin e Lipjanit edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e kësaj Rregulloreje në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Me datë 08.06.2026 është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit-debatit publik i draft organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në qytetin e lipjanit

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftim-per-debat-publik-per-Projekt-Rregulloren-per-organizimin-dhe-shfrytezimin-e-parkingjeve-publike-shqp.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 16.06.2026 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora ora 10:00

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://lipjan.rks-gov.net/news/mbahet-debat-publik-per-draft-rregulloren-per-organizimin-dhe-shfrytezimin-e-parkingjeve-publike-ne-qytetin-e-lipjanit/>

Gjatë këtij takimi draft Rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve publike në qytetin e Lipjanit u prezantua nga Sead Aliu – drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim.

Sead Aliu sqaroi para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë Draft Rregullore e cila pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth kësaj draft rregulloreje.

Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, duke përfshirë: qëllimin e hartimit të kësaj draft Rregulloreje, shfrytëzimi, rezervimi i parkingjeve dhe mënyra e pagesës, mënyra e organizimit të parkingjeve publike dhe menaxhimi dhe mirëmbajtja e parkingjeve.



Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim të Komunës së Lipjanit diskutoi për qëllimin e nxjerrjes së kësaj draft rregulloreje, mënyrën dhe shfrytëzimin e parkingjeve për kalimtarët dhe banorët rezident të Lipjanit si dhe procedura për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e parkingjeve, ndërsa theksoi se tarifat për pagesë për shfrytëzimin dhe kategoritë e liruar janë të përcaktuara me Rregulloren për Taksat Komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	15 ditë pranohen	23
2. Publikimi në ueb faqe	15 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 23 pjesëmarrës, prej tyre 13 femra dhe 10 meshkuj.

Po ashtu gjatë takimit janë pranuar edhe disa komente të cilat do i listojmë më poshtë.

Temat e konsultimit	komentet	Kush ka komentuar	Pergjegjia ne pyetje komente	Komenbtet (pranimi i pjeseshem dhe mos pranimi)
Draft Rregulloreja për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Qytetin e Lipjanit	–Asambleist në asamblenë komunale theksoi se sa i përket orarit të pagesës së parkingjeve konsideroj se është i gjatë dhe propozoj që pagesa për shfrytëzimin e parkingjeve të realizohet nga ora 08:00-19:00 ndërsa pas orës 19:00 të jetë pa pagesë si dhe të shtunave aplikohet pagesa vetëm nga ora 07:00 deri në orën 14:00.	Rinor Murati, asamblist	Drejtori Sead Aliu, ka thënë se do t'i propozoj komisionit që ta përfshijë sugjerimin tuaj në rregullore dhe më pas të ndërrohet orari sipas propozimit të juaj.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Rregulloreja për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve	Qytetarë i Lipjanit ngriti pyetjen se a do të shfrytëzohet parknigu nën tokësorë nga banorët rezident dhe a do të	Fitim Osmani, qytetarë	Drejtori Sead Aliu, ka thënë se parkingjet publike të cilat janë në pronësi të komunës dhe të cilat gjenden në	Komenti u pranua plotësisht

Publike në Qytetin e Lipjanit	ketë rezervim për këta banorë?		afërsi të ndërtesave të banimit do të shfrytëzohen vetëm nga banorët rezident të ndërtesës ndërsa parkingu nëntokësorë do të jetë i hapur për të gjithë shfrytëzuesit.	
Draft Rregulloreja për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Qytetin e Lipjanit	Asambleist në asamblenë komunale ngriti pyetjen se a do të ketë rezervim të vendparkingjeve për punëtorët e administratës komunale	Fadil Sopa, asmablist	Drejtori Sead Aliu, ka potencuar se nuk do të ketë vende të rezervuara për punëtorët e administratës komunale përveq veturave zyrtare të komunës.	Komenti u pranua plotësisht

Gjatë fazës së diskutimit publik lidhur **Draft Rregulloreja për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike në Qytetin e Lipjanit** Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranuar nga palët e interesuara.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin dhe zbatimin e konsultimeve publike



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Adresa	Nënshkrimi
1	Amila Regica Ilugiqi	Lipjan	
2	Fadil Sopa	Lipjan	
3	Rinor Murati	Lipjan	
4	Lumnije Leci	Lipjan	
5	Yacut Xhejlli	Lipjan	
6	Rizah Mustafa	Lipjan	
7	Fidim Osmani	Lipjan	
8	Stefan DEDUSTRI	LIPJAN	
9	Bleona Krashiqi	LIPJAN	
10	Arbnora Gashi	Lipjan	
11	Rita Sopa	Lipjan	
12	Bemzije Sopa	Lipjan	
13	GEZIM BYTYRI	LIPJAN	
14	Liridon Bejmullahu	Lipjan	
15	RINOR HAJRIZI	LIPJAN	
16	Kaltrina Krashiqi	LIPJAN	
17	Valdete Muzi	Lipjan	
18	Ruleda Bekodani	Lipjan	
19	Sazana Demiri-Rexhepi	Lipjan	
20	AVNI JASHARI	LIPJAN	
21	SAFET AMULLAHU	LIPJAN	
22	Besarta Gadraki	LIPJAN	
23	SCOD ALI	Lipjan	